

Nr 3273/1 prot  
14.05.2021



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
PREFEKTI QARKU FIER

Nr. 505/ Prot.

Fier, më 14.05.2021

**Lënda:** Kthim përgjigje për ligjshmërinë e vendimeve Nr 27, Nr 28, Nr 29 dhe Nr 30 datë 29.04.2021 të Këshillit Bashkiak Roskovec

**Drejtuar:** Znj. Majlinda **BUFI**  
KRYETAR I BASHKISË ROSKOVEC.

Z. Kadri **HYSKA**  
KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC.

**ROSKOVEC**

Në përgjigje të shkresës suaj me Nr. 3273 prot datë 30.04.2021, protokolluar me tonën me nr 505 prot, datë 06.05.2021 bazuar në Ligjin nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 8 shkronja "a" dhe neni 16, pasi shqyrtoam ligjshmërinë e vendimeve Nr 27, nr 28, nr 29 dhe nr 30, datë 29.04.2021 Të Këshillit Bashkiak Roskovec ju bëjmë me dije si më poshtë vijon:

**Vendimi Nr 27 datë 29.04.2021** i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për anulimin e vendimit nr 17 datë 31.03.2021 Për miratimin e rregullores për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në bashkinë Roskovec dhe " Anullimin e vendimit nr 18 datë 31.03.2021 për disa shtesa në vendimin nr 88 datë 02.12.2020 për miratimin e paketës fiskale për vitin 2021" Është në përputhje me Ligjin nr 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pika 2; Ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 8, pika 2; Ligjin nr 44/2015 Kodi i Procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë, neni 113.

**Vendimi Nr 28 datë 29.04.2021** i Këshillit Bashkiak Roskovec "Për miratimin e rregullores për ngritjen, funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në Bashkinë Roskovec" Është në përputhje me Ligjin Nr 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" neni 8 shkronja "a" neni 16, pika 2; Ligji Nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore" (i ndryshuar) neni 54, shkronja "k" neni 70 dhe 71 Ligji Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë" neni 3 pika 2.

**Vendimi nr 29 datë 29.04.2021 i Këshillit Bashkiak Roskovec “Për disa shtesa në vendimin Nr 88 datë 22.11.2020 ‘Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2021’** konstatojmë se vendimi përmban 2 pika, në pikën 1 është miratuar “Ndryshimi në paketën fiskale të vitit 2021 në kreun I.2.1 pika 4 dhe 5” të taksës së ndërtesës për sa i përket kategorive të përfshira, ndërsa në pikën 2 të vendimit është miratuar një tarifë e përkohshme ndaj kompanisë Albpetrol SH.A në masën prej 50 000 000 lekë për rehabilitimin e kanaleve kullues në fshatin Marinës me afat pagese të detyrimit 30 ditë nga momenti i marrjes së njoftimit të detyrimit nga kompania Albpetrol SH.A.

Bazuar në Ligjin Nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut” “Përgjegjësitë kryesore të Prefektit të Qarkut” neni 8 shkronja “a” Prefekti i Qarkut ka përgjegjësi kryesore verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhërësive me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”

- **Pika e 1 e vendimit** ka karakter normativ në kuptim të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 3 pika 2 dhe verifikojmë se Është në përputhje me Ligjin nr 107/2016 “Për prefektin e Qarkut” neni 8 shkronja a” neni 16, pika 2; Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar) neni 8 pika 2, neni 9 pika 1 nënpika 1.1 shkronja b; neni 54 shkronja “f” si dhe në zbatim të VKM Nr 144 datë 13.02.2020 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 132 datë 07.03.2018 të Këshillit të Ministrave “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ‘ndërtesa’, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës” (i ndryshuar).

- **Për pikën 2 të vendimit** konstatojmë se:

Nga ana e Këshillit të Bashkisë Roskovec është miratuar një tarifë e përkohshme ndaj kompanisë Albpetrol SH.A në masën prej 50 000 000 lekë për rehabilitimin e kanaleve kullues në fshatin Marinës me afat pagese të detyrimit 30 ditë nga momenti i marrjes së njoftimit të detyrimit.

Duke iu referuar paketës fiskale të Bashkisë Roskovec për vitin 2021 të miratuar me vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 88 datë 02.12.2020 vërejmë se nga ana e këshillit nuk është e parashikuar një tarifë e e tillë.

Konstatojmë se kemi të bëjmë me një marrëdhënie juridike dy palëshe ku palët janë të përcaktuara qartë nga njëra anë Bashkia Roskovec dhe nga ana tjetër kompania Albpetrol SH.A, gjithashtu objekti i kësaj marrëdhënie është konkret, pasojat janë konkrete dhe akti është shterues në zbatimin e tij, ndryshe nga akti normativ i cili ka karakter abstrakt dhe të përgjithshëm dhe ju drejtohet një kategori subjektësh të papaërcaktuara si dhe nuk është shterues në zbatimin e tij.

Gjithashtu përkufizimin për tarifën e jep Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 3 pika 10 ku parashikohet se “*Tarifë vendore është një pagesë që një individ person fizik apo juridik bën:*

- ✓ në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë
- ✓ të mirë publike specifike të përdorur
- ✓ apo të drejtë të dhënë nga njësi e vetëqeverisjes vendore”

Në Ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1 nënpika 1.3 shkronja b parashikohet “Njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi”. Referuar pikës 2 të vendimit të Këshillit Bashkiak Roskovec detyrimi që i kërkohet subjektit Albpetrol SH.A nuk është për një shërbim specifik të marrë nga bashkia pasi nuk është e

parashikuar një shërbim i tillë, nuk është për një të mirë publike specifike të përdorur pasi nuk provohet një gjë e tillë me një akt juridik lidhur mes Bashkisë Roskovec dhe subjektit Albpetrol SH.A si dhe nuk është për një të drejtë që i është dhënë pasi përsëri nuk ka një akt juridik për dhënien e ndonjë të drejte nga bashkia Roskovec .

Pra nuk jemi përpara asnjë prej rasteve të parashikuar nga ligji për vendosjen e kësaj tarife.

Ligji organik Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) neni 9 parashikon shprehimisht se NJVQV-të vendosin tarifa për shërbimet e tyre.

Nga relacioni që i është bashkëlidhur vendimit na bëhet me dije se kompania Albpetrol SHA ka shkaktuar ndotje në kanalet kulluese të zonës së Marinzës pasi është konstatuar përmbajtje sere dhe për rehabilitimin e këtyre kanaleve është miratuar ky detyrim i quajtur “tarifë” në masën 50 000 000 leke.

Pavarësisht së në vendim përdoret termi “tarifë” ne respektim të Ligjit Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 3 pika 10, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1 nënpika 1.3 shkronja b’ nuk kemi të bëjmë me vendosjen e një tarife.

Për sa më sipër në bazë të të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 3 pika 2, pika 2 e vendimit Nr 29 datë 29.04.2021 të Këshillit Bashkiak Roskovec nuk ka karakter normativ dhe verifikimi ligjor i kësaj pike nuk është në kompetencën e prefektit bazuar në Ligjin Nr. 107/2016 “Për prefektin e Qarkut” “Përgjegjësitë kryesore të Prefektit të Qarkut” neni 8 shkronja “a.

**Vendimi nr 30 datë 29.04.2021** “Për miratim dhe transferim fondesh në buxhetin e Bashkisë Roskovec për vitin 2021” konstatojmë se vendimi përmban 2 pika.

**Pika 1 e vendimit.** Në këtë pikë kemi të bëjmë me transferim fondesh brenda të njëjtit program, atë të investimeve. Me Vendimin nr 89 datë 02.12.2020 kemi miratuar Buxhetin në të cilin janë miratuar edhe detajimet sipas programeve. Bazuar në Ligjin nr 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar, neni 44, pjesa e dytë, shkronja “b” rishpërndarjet e projekteve të investimeve, brenda të njëjtit program, miratohen nga kryetari i njësive të qeverisjes vendore; Në bazë të Ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 3 pika 2, pika 1 e këtij vendimi nuk është me karakter normativ. Akti normativ në kuptim të ligjit përmban rregulla të detyrueshme sjelljeje për një marrëdhënie juridike ose kompleks marrëdhëniesh juridike të përgjithshme. Ai i drejtohet një kategorie të ose hipotetike si dhe nuk është i shteruar në zbatimin e tij. Pika 1 e Vendimi nr 30 datë datë 29.04.2021 i Këshillit Bashkiak Roskovec nuk plotëson kriteret për tu klasifikuar me karakter normativ Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut” neni 8 “Përgjegjësitë kryesore të prefektit të qarkut” shkronja “a” “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve urdhërave, urdhëresave me karakter normativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”. Për sa më sipër verifikimi i ligjor i kësaj pike nuk është në kompetencën e prefektit të qarkut.

**Pika 2 e vendimit nr 30 datë 29.04.2021** Është në përputhje me Ligjin nr 107/2016 “Për prefektin e Qarkut” neni 8 shkronja “a” neni 16, pika 2; Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” neni 3 pika 2; Ligji Nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” (i ndryshuar) neni 36, dhe neni 54 shkronja “dh”; Ligji nr 68/2017 ‘Për Financat e

vetëqeverisjes vendore” neni 30; Ligjit Nr 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” (i ndryshuar) neni 15.

*Sjellim në vëmendjen tuaj se në bazë të Ligjit nr 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” neni 8, shkronja “a” Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e vendimeve urdhërave, urdhëresave me karakter normativ të njësive të vetëqeverisjes vendore, ndaj aktet e organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore që dërgohen për verifikim ligjor në përbërje të tyre duhet të jenë tërësisht me karakter normativ.*

**Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,**

**PREFEKTI**

**Baki BALA**

